



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prizrenit

Drejtoria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit - tel: 029/ 626-143

Sektori i Rinisë

Politikat rinore të Komunës së Prizrenit

Hyrje

Të rinjtë në komunën tonë duhet të ndjehen të lirë të ndjekin ëndrrën e tyre, të ndjehen të përkrahur dhe të kenë informacione të plota për mundësitë e realizimit të potencialit individual dhe njëkohësisht të kenë qasje në informata për shërbimet shëndetësore, arsimimin, punësimin, çështjet juridike dhe çështjet tjera me rëndësi për një zhvillim të papenguar të tyre. Mbi këto parime, Politika rinore e Kuvendit të komunës së Prizrenit synon promovimin e marrëdhënieve aktive midis komunës dhe të rinjve.

Në veçanti Kuvendi njih rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje, në të gjitha proceset që e prekin statusin e të riut dhe zhvillimin individual si qytetar aktiv sot dhe bazë për zhvillim të qëndrueshëm të komunës tani dhe në të ardhmen.

Për ta zhvilluar këtë politikë është angazhuar një numër i madh i të rinjve ,organizatave rinore, ekspertëve të fushës dhe janë identifikuar pesë fusha prioritare. Dokumenti paraqet një platformë fillestare ndërmjet të nevojshmes dhe të mundshmes për (1) avancimin e infrastrukturës rinore (2) rritjen e pjesëmarrjes aktive të rinisë në proceset shoqërore (3) krijimin e mundësive dhe përkrahjen e punësimit të rinjve (4) edukimin cilësor dhe parandalimin e dukurive të shëmtuara tek të rinjtë si dhe (5) fuqizimin dhe qëndrueshmërinë e Qendrës Rinore dhe të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL). Këto fusha e sigurojnë një bazë fillestare për formulimin e programeve konkrete duke u përqendruar në pesë prioritetet, por në asnjë mënyrë nuk përkufizojnë të gjitha nevojat e të rinjve.

Zhvillimi i politikave rinore paraqet një poqes të vazhdueshëm të grumbullimit të dhënave, administrimit dhe analizimit të tyre me qëllim të njohjes së saktë të gjendjes së të rinjve, nevojave aktuale dhe aspiratave të tyre. Për këtë qëllim të gjitha drejtoritë komunale dhe institucionet që ofrojnë shërbime profesionale në koordinim të ngushtë me drejtorinë përgjegjëse për rini, do të nxjerrin çdo vit një raport për gjendjen e të rinjve dhe përmes konsultimeve me të rinjtë dhe organizatat rinore, për vizionin e tyre. Për qëllimet e zbatimit të kësaj politike mosha rinore është përkufizuar si grupmoshë prej moshës 15 deri 24 vjeçare, meshkuj dhe femra, nga fshati dhe qyteti dhe pa dallim përkatësie etnike, fetare dhe sociale.

Kuvendi i komunës së Prizrenit inkurajon të rinjtë të ndihmojnë që qyteti i Prizrenit dhe e gjithë komuna të bëhet një vend i bukur dhe atraktiv për të rinjtë, për të gjithë qytetarët, për vizitorët dhe investitorët vendas dhe të huaj.

Duke i aprovuar Politikën rinore, kuvendi komunal zotohet për një partneritet në vazhdimësi me shoqërinë civile dhe në veçanti me të rinjtë e komunës, institucionet dhe organizatat e tyre të përfaqësimit.

Janë identifikuar pesë (5) politika kryesore të cilat mendohen të zbatohen në komunën e Prizrenit. Periudha zbatuese e politikave të propozuara është tri vjeçare dhe përfshin periudhën 2012 – 2014.

Politikat e propozuara për miratim janë:

1. Avancimi i infrastrukturës rinore
2. Pjesëmarrja aktive e rinisë në proceset shoqërore
3. Krijimi i mundësive dhe përkrahja e punësimit të të rinjve
4. Edukimi dhe parandalimi i dukurive të dëmshme për rininë
5. Fuqizimi dhe qëndrueshmëria e Qendrës Rinore dhe Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)

Për secilën politikë të propozuar është pasqyruar buxheti. Vlera e përgjithshme e zbatueshmërisë së politikave të propozuara për periudhën trevjeçare është ~ 130.850 Euro.

1. Avancimi i infrastrukturës rinore

Çështja/Përshkrimi:

Mungesa e politikave të qëndrueshme ka bërë që sot një numër i madh i organizatave, grupeve dhe individëve të moshave rinore në qytetin e Prizrenit të mos kenë hapësira fizike ku mund të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e veta jashtë sistemit të arsimit formal. Po ashtu, edhe shumë të rinj jashtë shkollorë, që janë të papunësuar, kanë nevojë për këto hapësira fizike për të ushtruar e zhvilluar aktivitete e njohuri në lëmi të ndryshme. Me një dizajnim më të mirë të politikave për rininë do të kishim arritur që të ndikonim në përmirësimin e infrastrukturës rinore si asaj fizike ashtu dhe asaj ligjore.

Qëllimi:

1.1. Sigurimi i objekteve, dedikuar grupeve dhe organizatave rinore

1.2. Rritja e buxhetit për çështjet që lidhen me rininë

Masat:

1.1.1. Të identifikohen objektet dhe hapësirat ekzistuese të cilat potencialisht mund të shfrytëzohen për aktivitetet rinore

1.1.2. Arrihet marrëveshja ndërmjet drejtorive gjegjëse me qëllim që të sigurohen objektet publike falas në shërbim të organizatave rinore¹ për zhvillimin e aktiviteteve rinore

1.1.3. Identifikohen dhe kontaktohen organizatat rinore dhe u ofrohet mundësia e shfrytëzimit të objekteve dhe hapësirave tashmë të dedikuara për të rinjtë

1. 2.1. Organizohen takime periodike mes organizatave rinore, institucioneve komunale dhe komunitetit donator

1. 2.2. Mblidhen dhe ofrohen të dhëna për nevojat buxhetore për çështjet rinore përfshirë dhe sektorin komunal të rinisë

Ndikimi i politikës së zbatuar:

Me aprovimin dhe zbatimin e kësaj politike për avancimin e infrastrukturës rinore pritet që objektet dhe hapësirat ekzistuese të shfrytëzohen nga organizatat rinore, të cilave u lehtësohet qasja pasi kjo politikë zvogëlon ngarkesat financiare për zhvillimin e aktiviteteve. Kjo politikë ofron gjithë-përfshirjen e rinisë në synimin e ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë. Kjo politikë po ashtu zgjon interesimin e komunitetit të donatorëve por edhe të palëve të tjera të interesit për të përkrahur iniciativat rinore si psh ofrimi i trajnimeve, kurseve për rininë jashtë shkollës, trajtimin e çështjeve me të cilat ballafaqohet rinia në vendet rurale, trajtimin e çështjeve me të cilat ballafaqohet rinia e etnive jo-shqiptare, përkrahja e aktiviteteve që përmirësojnë pozitën e femrës në shoqëri, të personave me

¹ Me organizata rinore nënkuptohen OJQ-të rinore, grupet joformale të shkollave si klubet e shkencëtarëve të rinj etj. Organizatat rinore politike përjashtohen nga ky definicion.

aftësi të kufizuar përfshirë edhe rininë në shkolla.

Kjo politikë hap dyert dhe ofron mundësitë për ndërmarrjen e aktiviteteve në bashkëpunim edhe me institucionet tjera lokale dhe qendrore, po ashtu edhe me komunitetin e biznesit.

Bartësit:

DKRS/Spektori i rinisë, KVRL, drejtoritë përkatëse të Kuvendit Komunal

Përkrahësit:

OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare, organizatat rinore jo-formale, institucionet shkollore dhe palët tjera të interesit

Vlera e përafërt e zbatimit:

1.1.1. 2700 Eur (shpenzimet e transportit: 3 x 300 Eur x 3 vjet)

1.1.3. 1800 Eur (shpenzimet e transportit dhe komunikimit: 3 x 200 Eur x 3 vjet)

1.2.1. 4500 Eur (3 takime x 500 Eur për takim x 3 vjet)

1.2.1. 4500 eur (1 hulumtim/analizë për vit x 3 vite x 1500 Eur)

Gjithsej vlera e zbatimit të politikës: ~ 13.500 Eur

2. Pjesëmarrja aktive e rinisë në proceset shoqërore

Çështja:

Sipas të dhënave nga statistikat zyrtare, si në të gjithë Kosovën ashtu edhe në Prizren, të rinjtë paraqesin më shumë se gjysmën e popullatës së kësaj komune. Pjesëmarrja e të rinjve në proceset shoqërore është shumë e ulët dhe të dhënat statistikore tregojnë rënie të interesit të tyre për përfshirje në proceset shoqërore². Prandaj, është e rëndësishme që të përkrahen të rinjtë në ngritjen e kapaciteteve të pjesëmarrjes aktive, ngritjes së bashkëpunimit dhe kyçjes në vendimmarrje, duke përfshirë të rinjtë nga zonat rurale, të rinjtë nga minoritetet, të rejtat dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, si dhe të gjithë të rinjtë e tjerë. Ne mendojmë, se një përkrahje e tillë që u mundëson avancimin në pjesëmarrje dhe ngritjen e aftësive pjesëmarrëse të të rinjve, është interes i gjithë shoqërisë kosovare e në veçanti asaj prizrenase.

Qëllimi:

2.1. Hartimi i urdhëresës dhe lëshimi i vendimit për drejtoritë komunale përmes së cilës strukturave rinore u ofrohet mundësia e përfshirjes në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet ku preket interesi i rinisë

2.2. Ndërgjegjësimi i rinisë dhe i strukturave të tyre për pjesëmarrje të shtuar në proceset shoqërore

Masat:

2.1.1. Organizohen takime me strukturat udhëheqëse të komunës

2.1.2. Ofrohet asistencë teknike në hartimin e urdhëresës

2.1.1. Organizohen fushata informuese dhe ndërgjegjësuere për përfshirje të strukturave rinore në vendim-marrje

2.2.2. Ndërmerren nismat për përfshirje të strukturave rinore në vendim-marrje

2.2.3. Përkrahen këshillat rinore të shkollave lidhur me shënimin e datave të rëndësishme

Ndikimi i politikës së zbatuar:

- Të organizojë dhe përkrahë trajnime për ngritjen e kapaciteteve të të rinjve
- Të organizojë aktivitete ndërkulturore dhe projekte të përbashkëta brenda dhe jashtë komunës
- Të përkujdeset për shtrirje të organizatave dhe grupeve rinore në zonat rurale

² Me përfshirje në proceset shoqërore në këtë politikë nënkuptohet përfshirja e strukturave rinore në vendim-marrje, gjegjësisht prezenca dhe ofrimi i alternativave nga ana e strukturave rinore në takimet vendim-marrëse të organeve komunale.

- Të përkujdeset dhe të përkrahë aktivitetet mes grupeve dhe organizatave rinore të etnive të ndryshme
- Të organizojë kampe rinore për të rinjtë
- Të krijojë marrëdhënie frytdhënëse me grupe apo organizata rinore
- Të përkrahen programet për shkëmbime të ndërsjellta mes të rinjve
- Ngritja e kapaciteteve të organizatave dhe grupeve rinore
- Të ofrojë mundësi për kyçje të rinisë në aktivitete me grupe të tjera (koalicionet dhe aleancat)
- Të identifikojë rininë pasive

Bartësit:

DKRS/Sektori i rinisë, Kryetari i komunës, KVRL, Drejtoritë komunale

Përkrahësit:

OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare, shkollat e mesme dhe shkolla e lartë, sektori i kulturës dhe sportit, departamenti i rinisë në nivel qendror.

Vlera e përafërt e zbatimit:

2.2.1. a) 3 koncerte (1 koncert x 1800 x 3 vjet ~ 5400 Eur)

b) 6 TV debate/emisione (2 debate x 150 Eur x 3 vjet ~ 900 Eur)

c) 9 radio-debate (3 debate x 100 Eur x 3 vjet ~ 900 Eur)

ç) 3 TV spote (3 TV spote x 750 Eur për spot ~ 2250 Eur)

d) Broshura (30000 x 0.5 Eur ~ 15.000 Eur)

e) Informatorë (10.000 x 0.1 ~ 1000 Eur)

2.2.3. 10 nisma të këshillave x 200 Eur x 3 vjet ~ 6.000 Eur

Gjithsej vlera e zbatimit të politikës: ~ 31.450 Eur

3. Krijimi i mundësive dhe përkrahja e punësimit të të rinjve

Çështja:

Numri më i madh i qytetarëve të komunës sonë përbëhet nga grup-mosha rinore të cilët janë të prekura nga papunësia. Kjo situatë është një mundësi më shumë në drejtimin e këtyre të rinjve ndaj dukurive negative për shoqërinë si: krimin dhe prostitucionin, abuzimin me drogën, përdorimin e alkoolit, emigrimin etj. Për këtë arsye, është më se e nevojshme që, të rinjve punëkërkues të cilët janë të gatshëm për tregun e punës, t'i përkrahim dhe atyre të rinjve që s'janë të gatshëm për tregun e punës t'ju sigurojmë një edukim më të mirë.

Qëllimi:

- 3.1. Identifikohen profilet deficitare të tregut të punës në komunën e Prizrenit
- 3.2. Ndërgjegjësohet, inkurajohet dhe përkrahet rinia lidhur me shkathtësitë për vetëpunësim
- 3.3. Zhvillohen shkathtësitë e të rinjve përmes Qendrës për Aftësim Profesional
- 3.4. Qendra e Punësimit ndërmerr veprime afirmative³ lidhur me punësimin e të rinjve

Masat:

- 3.1.1. Kryhen hulumtime të vazhdueshme për kërkesat e tregut të punës
- 3.1.2. Komuna stimulon nismat të cilat çojnë drejt punësimit të t'rinjve
- 3.2.1. Organizohen fushata të vazhdueshme ndërgjegjësuese për rininë lidhur me orientimin në karrierë
- 3.3.1. Organizohen trajnime të vazhdueshme për të rinjtë në profilet deficitare të tregut të punës
- 3.4.1. Qendra e punësimit harton politikën e brendshme me të cilën në çdo proces të punësimeve përfshihen të paktën 50 % e të rinjve të evidentuar si të papunë

Ndikimi i politikës së zbatuar:

- Të organizojë dhe përkrahë trajnime për rininë e pakualifikuar dhe rininë me aftësi të kufizuara
- Të bashkëpunojë dhe përkrahë hapjen e atyre shkollave profesionale apo OJQ - ve rinore që merren me këto trajnime specifike
- Organizimi i seminareve, trajnimeve për aftësimin dhe stimulimin e të rinjve për krijimin e bizneseve të vogla, po ashtu edhe për vetëpunësim

³ Me veprime afirmative nënkuptohet politika favorizuese për grupe të caktuara të marginalizuara

Bartësit:

DKRS/Sektori i rinisë, Kryetari i komunës, KVRL, Drejtoritë komunale

Përkrahësit:

OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare, shkollat e mesme dhe shkolla e lartë, sektori i kulturës dhe sportit, departamenti i rinisë në nivel qendror.

Vlera e përafërt e zbatimit:

3.1.1. 3 hulumtime x 1500 Eur x 3 vjet ~ 4500 Eur

3.1.2. a) 6 TV emisione tematike (2 debate x 150 Eur x 3 vjet ~ 900 Eur)

b) 3 TV spote tematike (3 TV spote x 750 Eur për spot ~ 2250 Eur)

c) 9 radio emisione tematike (3 debate x 100 Eur x 3 vjet ~ 900 Eur)

ç) Broshura (10.000 x 0.5 Eur ~ 5.000 Eur)

d) Informatorë (10.000 x 0.1 ~ 1000 Eur)

3.2.1. a) 6 TV emisione tematike (2 debate x 150 Eur x 3 vjet ~ 900 Eur)

b) 3 TV spote tematike (3 TV spote x 750 Eur për spot ~ 2250 Eur)

c) 9 radio emisione tematike (3 debate x 100 Eur x 3 vjet ~ 900 Eur)

çl Ndërtimi i panosë informuese për punësim (1 x 3000 Eur)

Gjithsej vlera e zbatimit të politikës: ~ 21.600 Eur

4. Edukimi dhe parandalimi i dukurive të dëmshme për rininë

Çështja:

Me dukuri të dëmshme për rininë është janë nënkuptuar përdorimi i substancave të dëmshme për shëndetin dhe dukuritë e sjelljeve asociale. Moshë e re e popullatës, situata epidemiologjike në botë, infektimi nga HIV/AIDS me indikacione të shtimit të numrit të të rinjve të infektuar, prania e shprehur e konsumimit të substancave narkotike janë arsye që të ndërmerren veprime edukimi dhe parandalimi ndaj këtyre dukurive negative. Njohuritë e pamjaftueshme për këto dukuri negative, mungesa e përvojës parandaluese, mungesa e përfshirjes së të rinjve në luftën kundër këtyre dukurive, krijojnë bazë për zhvillimin e këtyre dukurive devijuese.

Qëllimi :

- 4.1. Ndërgjegjësimi i të rinjve për dukuritë negative
- 4.2. Përfshirja sa më e madhe e të rinjve në aktivitetet kundër dukurive të këqija
- 4.3. Parandalimi i përdorimit të narkotikëve, alkoolit dhe duhanit

Masat:

- 4.1.1. Organizohen fushata ndërgjegjësuëse lidhur me dukuritë negative
- 4.2.1. Këshillat rinore të shkollave të mesme organizojnë debate garuese lidhur me dukuritë negative
- 4.3.1. Angazhohet drejtorja e inspektorateve të ndërmarrin aksione të rregullta në ndalimin e shitjes së duhanit dhe alkoolit personave nën moshën e lejuar

Ndikimi i politikës së zbatuar::

- Botimi i materialeve edukativo - propaganduese shëndetësore mbi dukuritë devijuese
- Trajnimi i trajnerëve prej moshave rinore, të cilët do të bartin më tej njohuritë e tyre
- Bashkëpunimi me grupet dhe OJQ - të rinore
- Bashkëpunimi me entet shkollore dhe shëndetësore

Bartësit:

DKRS/Sektori i rinisë, KVRL, Drejtoritë komunale

Përkrahësit:

OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare, shkollat e mesme dhe shkolla e lartë, sektori i kulturës dhe sportit, departamenti i rinisë në nivel qendror.

Vlera e përafërt e zbatimit:

- 4.1.1. a) 3 koncerte (1 koncert x 1.800 x 3 vjet ~ 5.400 Eur)
- b) 6 TV debate/emisione (2 debate x 150 Eur x 3 vjet ~ 900 Eur)
- c) 9 radio-debate (3 debate x 100 Eur x 3 vjet ~ 900 Eur)
- ç) 3 TV spote (3 TV spote x 750 Eur për spot ~ 2.250 Eur)
- d) Broshura (30.000 x 0.5 Eur ~ 15.000 Eur)
- e) Informatorë (10.000 x 0.1 ~ 1.000 Eur)
- 4.2.1. (3 debate x 500 Eur x 3 vjet ~ 4.500)

Gjithsej vlera e zbatimit të politikës: ~ 29.950 Eur

5. Fuqizimi dhe qëndrueshmëria e Qendrës Rinore dhe Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)

Çështja:

Qendra Rinore dhe KVRL-ja sfidohen nga qëndrueshmëria e brishtë institucionale. Këto dy palë, për shkak të pamundësisë financiare nuk mund të përfaqësojnë në teësi interesat e të rinjve prizrenas dhe nuk ka kapacitete të mjaftueshme që përmes aktiviteteve të ndryshme të orientojnë rininë në kahjene dëshiruar. Po ashtu kjo qendër nuk njihet si entitet legal ose nuk ka miratim zyrtar (licencë) nga komuna ashtu që kjo qendër të jetë në pajtim me kërkesat e agjencioneve donatore lidhur me përkrahjen e eventuale. Po ashtu personeli kyç që merret me çështjet rinore si nga qendra ashtu edhe KVRL-ja nuk kanë zotësi të mjaftueshme në fushën e planifikimit dhe menaxhimit, andaj konsiderohet si i domosdoshëm ndërtimi i këtyre kapaciteteve. Në anën tjetër, pamundësia që në qendër të angazhohet staf i rregullt bën që qendra të mos jetë e përfaqësuar denjësisht dhe përkushtimi të mos jetë në nivelin e dëshiruar.

Qëllimi :

- 5.1. Qendra Rinore dhe KVRL-ja janë entitete legale
- 5.2. Bashkëpunimi i vazhdueshëm i Qendrës së Rinisë dhe KVRL-së me agjencionet donatore vendore dhe ndërkombëtare
- 5.3. Ngritja e kapaciteteve për anëtarët e Qendrës Rinore dhe KVRL-së në fushën e qëndrueshmërisë institucionale
- 5.4. Përkahja e KVRL-së dhe Qendrës Rinore përmes ndarjes së mjeteve financiare
- 5.5. Qendra rinore dhe KVRL-ja përkrahin aktivitetet e grupeve formale dhe joformale rinore

Masat:

- 5.1.1. Licensohet Qendra Rinore dhe KVRL-ja si organe rinore komunale
- 5.2.1. Mbahen kontaktet e vazhdueshme me agjencionet donatore vendore dhe ndërkombëtare
- 5.2.2. Organizohen takime të vazhdueshme me palët e interesit
- 5.2.3. Informohen të gjitha palët për aktivitetet dhe nevojat e ndryshme të Qendrës Rinore
- 5.2.4. Rritja e anëtarësisë rinore dhe krijimi i mekanizmave për anëtarësim të vazhdueshëm
- 5.3.1. Ndërtohen kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese të personelit të Qendrës Rinore dhe KVRL-së
- 5.4.1. Planifikohen dhe alokohen mjete financiare për Qendrën Rinore sipas Udhëzimit Administrativ gjegjës
- 5.4.2. Hartohet plani vjetor i punës së Qendrës Rinore dhe KVRL-së
- 5.5.1. Krijohen pako të shërbimeve specifike për assistencë grupeve rinore dhe rritjes së ndikimit të Qendrës Rinore dhe KVRL-së

Ndikimi i politikës së zbatuar:

- Qendra Rinore bëhet entitet legal dhe fiton bazën për përfitimin e granteve të ndryshme rinore
- Qendra Rinore fiton qëndrueshmërinë institucionale në kryerjen e funksionit të vet
- Personeli që merret me rininë prizrenase ka njohuri dhe shkathtësi të mjaftueshme për të përfaqësuar interesat e rinisë dhe për të zhvilluar aktivitete që ndihmojnë rininë në zhvillimin e tyre
- Bashkëpunimi i koordinuar i të gjitha organeve rinore prizrenase me entitetet tjera vendore dhe nsërkombëtare

Bartësit:

DKRS/Sektori i rinisë, Qendra Rinore, KVRL, Drejtoritë komunale

Përkrahësit:

Organizatat lokale dhe ndërkombëtare, shkollat e mesme dhe Universiteti i Prizrenit, sektori i kulturës dhe sportit, departamenti i rinisë në nivel qendror.

Vlera e përafërt e zbatimit:

- 5.2.2. 30 takime (1 takim x 20 Eur për reprezentim x 30 takime x 3 vjet ~ 1.800 Eur)
- 5.2.3. 4 fushata informuese në vit (4 fushata informuese x 500 Eur x 3 vjet ~ 6.000 Eur)
- 5.2.4. Rritja e anëtarësisë, mekanizmat (materialet shpenzuese x 150 Eur x 3 vjet ~ 450 Eur)
- 5.3.1. Organizohen trajnime për planifikim dhe menaxhim (3 trajnime 3 ditore x 2.100 Eur x 3 vjet ~ 6.300 Eur)
- 5.4.1. 2. Stafi i Qendrës Rinore (400 Eur x muaj x 3 vjet ~ 14.400 Eur)
- 5. 4.1.2. Angazhimi i konsulencës profesionale (3 persona x 600 Eur x 3 vjet ~ 5.400 Eur)

Gjithsej vlera e zbatimit të politikës: ~ 34.350 Eur

Dokumenti është hartuar me pjesëmarrje nga:

- 1) Anëtarët e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal
- 2) Qendra e Rinisë
- 3) Sektori komunal për rini
- 4) Organizatat rinore të komunës së Prizrenit
- 5) Iniciativa 6
- 6) Handikos
- 7) Skender Boshtrakaj
- 8) Bari Zenelaj
- 9) Arben Shala
- 10) Erkan Vardari

Sektori komunal për rini i falënderon të gjithë pjesëmarrësit tjerë të cilët kanë dhënë kontributin për hartimin e këtij dokumenti gjithëpërfshirës.

Prizren, Dhjetor 2011